

Rael Qeleshi

Mban pozicionin e Avokatit të Shtetit pranë Avokaturës së Shtetit, në Zyrën e Këshillimit dhe Koordinimit Ndërministror. Më parë është emëruar si Avokat Shteti në Korrik 2019 pranë Zyrës së Përfaqësimit në Gjykatat e Huaja, Ndërkombëtare dhe Arbitrazhin Ndërkombëtar, ku ka ushtruar funksionin e tij si Avokat Shteti, duke siguruar mbrojtjen dhe përfaqësimin e interesave shtetërorë në çështje arbitrazhi ndërkombëtar dhe vendas, deri më Gusht 2023.

Diplomuar për Drejtësi në vitin 2013, me rezultate të shkëlqyera me titullin “Bachelor”, dhe më pas në vitin 2015 me titullin “Master Shkencor në të Drejtën Penale” në Universitetin Jo-Publik “Luarasi”. Përgjatë viteve 2011-2012 është angazhuar si praktikant (internship) për organizata të ndryshme si Komiteti i Helsinkit (CPT) dhe Institute for Police and Legal Studies (IPLS). Prej vitit 2016 i licencuar prej Dhomës Kombëtare të Avokatisë me titullin “Avokat”, titull i marrë në përfundim të ciklit akademik dhe testimit të tij në Shkollën e Avokatisë.

Përgjatë viteve 2016-2018 ka ushtruar funksionin e tij si specialist-jurist në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, në Sektorin e Programimit, Hartimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore, ku është përkushtuar në hartimin e projektakteve të ndryshme ligjore dhe nënligjore, dhënien e opinionëve ligjore institucionale, si dhe përfaqësimin në procedimet gjyqësore administrative dhe civile, Ministria ka qenë palë.

Përgjatë viteve 2018-2019 ka realizuar profesionin e tij si jurist dhe avokat në shoqërinë aksionere American Hospital Sh.a., Departamenti Juridik, ku ka kontribuar në hartimin e draft-kontratave të ndryshme, si dhe në asistencën dhe përfaqësimin në procedimet gjyqësore civile dhe tregtare, ku shoqëria ka qenë palë.

Në Qershor 2019 është emëruar Oficer i Policisë Gjyqësore në Prokurorinë e Përgjithshme, detyrë të cilën e ka ushtruar me dedikim deri në emërimin e tij në Avokaturën e Shtetit.